

SIE BESTELLEN PAKETE ZU SICH NACH HAUSE WARUM ALSO WOANDERS ABHOLEN?



"LegalLeaks", trajnimi i KMSHK për qasjen e gazetarëve në informata



2014-06-03 14:23:16

Qasje në informata, e drejta në qasje dhe pse është ajo e rëndësishme për gazetarët, ishin tema kyçe të trajnimit dyditor të titulluar Legal Leaks, të cilin organizoi Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës së bashku me UNESCO-n dhe organizatën Access info Europe.

Ky trajnim në Prishtinë tuboi shumë gazetarë dhe studentë të gazetarisë, të cilët dëgjuan paraqitjet nga Adeline Hulin, Sektori i Komunikimeve dhe i Informacionit në UNESCO, Helen Darbshire, drejtoreshë e Access info Europe, Victoria Anderica, hulumtuese dhe zhvilluese e fushatës pranë Access info Europe.

Nga përfaqësuesit e Këshillit të Mediave të Kosovës ligjeroi prof. dr. Ibrahim Berisha, kryetar i bordit të KMSHK-së. Ai informoi të pranishmit mbi funksionimin, mekanizmat dhe sfidat e Këshillave të Mediave, ndërsa Flutura Kusari, anëtare e bordit të KMSHK-së, paraqiti temën: "Kërkimi i informatave në Kosovë: të kuptuarit e legjislacionit" duke informuar kështu të pranishmit mbi të drejtat e qytetarëve dhe gazetarëve në veçanti, për të kërkuar të dhëna nga institucionet e ndryshme në Kosovë.

Gresa Musliu, koordinatore për lirinë e qasjes në informata pranë BIRN-it, prezantoi pesë raste që ajo ka inicuar për të marrë informata nga institucionet publike, dhe sfidat nëpër të cilat ajo ka kaluar për të marrë ato informata.

Gjatë këtij trajnimi, u prezantua edhe Udhëzuesi për gazetarë për qasje në dokumente publike, botim i Access info Europe, UNESCO-s, dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Like 6 Tweet 0 Print Share

OSBE ndihmon komunat në hartimin e planeve për banim social

Për vetëdijesim Dita e Mjedisit në kryeqytet u shënua me biçikleta

Në "Shkupi 2014" fontanë përmasash gjigante, përmendoret e shqiptarëve askund

Swisscoy në Kosovë deri në fund të 2017-ës

Sundimi i ligjit, sfidë për qeverinë e ardhshme të Kosovës


Për skandalin e pasaportave dëshmon kompania gjermane OESD

Zhbogar për zgjedhje të drejta e të lira

Përzgjedhet logoja për 70-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë

Sonte në "Rubikon": Nënkryetarët e parë të partive politike që garojnë në zgjedhje

At Nikolla Marku: Irinej



TË TJERA



OSBE ndihmon komunat në hartimin e planeve për banim social - 2014-06-05 15:22:06
Dragash, 5 qershor -



Për vetëdijesim Dita e Mjedisit në kryeqytet u shënua me biçikleta - 2014-06-05 15:18:58

Në "Shkupi 2014" fontanë përmasash gjigante, përmendoret e shqiptarëve askund - 2014-06-05 15:16:42

Mustafa: Thaçi është në panik, shpëtimi i tij është opozita - 2014-06-05 15:15:37

Jacobson: Jetike që të gjitha komunitetet do të votojnë të dielën - 2014-06-05 15:13:31



Lajmet e Mbrëmjes



Debati në Rubikon

provokoi gjithë
shqiptarët

Komente Komuniteti

Identifikohu ▾

Rendit sipas më të mirave ▾

Shpërndaje ↗ E preferuar ★



Filloni diskutimin...

Bëhu i pari që komenton.

✉ Regjistrohu

👤 Përdoreni Disqus në faqen tuaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. **Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.**

ec me kohën...  Like  28k